



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

Aneksi 2 – Njoftim i Takimeve Informuese

Njoftim i Takimeve Informuese/Trajnimeve

Në datën **09/12/2025, ora 10.30**, në ambientet e Qendrës Rinore Multifunkionale, jeni të ftuar të ndiqni një takim informues për thirrjen e Bashkisë Durrës, “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”, i cili do të ofrojë asistencë financiare në mbështetje të planeve të biznesit të aplikimeve fituese për zbatimin e ideve për vitin 2025-2026.

Mendoni se keni një ide biznesi të suksesshme dhe nuk keni mbështetje financiare? Mos hezitoni! Thirrja e Bashkisë Durrës për të rinjtë ofron një mundësi për të financuar idenë tuaj të biznesit si dhe ju ofron trajnim në planifikim biznesi, aftësi në biznes, kërkim për mbështetje të tjera financiare dhe konsultime me këshillues të njohur të fushës.

Kandidatët dhe pjesëmarrësit në skemë **janë të rinj/ të reja të moshës 18 – 30 vjec që jetojnë dhe kanë një ide ose kanë biznese të vogla/ të mesme në territorin e Bashkisë Durrës**, në kohën e aplikimit.

Fondi për “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale” është projekt i Bashkisë Durrës i financuar nga burime publike dhe hartuar për të mbështetur krijimin, ose zgjerimin e aktiviteteve të mundshme për biznes nga të rinj që janë të aftë që të jenë të suksesshëm në një treg konkurrues.

Skema është zbatuar përmes një procesi konkurimi, për të marrë kështu fitimin më të lartë të mundshëm nga investimi. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve ka si qëllim të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të drejtë dhe të mbështesë idetë dhe planet e biznesit më të mira, innovative dhe me me shumë përfitim si dhe garantojnë rezultate të qëndrueshme.

Takimi do të ndiqet nga Koordinatori dhe gjatë takimit do të prezantohen kushtet për pjesëmarrje, afatet për aplikim dhe fazat e zbatimit të skemës.